



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tridhjetë e pesë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **28.02.2025**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|----------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Nexhmedin Balaj AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 16. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 17. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 5. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 18. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 19. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 20. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 8. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 21. <u>Andi Xhuraj PDK;</u> |
| 9. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 22. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Arianit Selmanaj LDK;</u> | 23. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 11. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 24. <u>Djula Karisik, GIBI;</u> |
| 12. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> | |
| 13. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1") (Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në <https://www.youtube.com/watch?v=WA3ENk5SlR0> <https://www.youtube.com/watch?v=T7KA4IZXoJl> "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.
Hap punimet për mbledhjen e tridhjetë e pestë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 24 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për Ndarjen e Pronës Komunale për Ndërmarrjen Publike Qendrore Korporata e Ruajtjes së Energjisë KRE SH.A (Lokacioni Bellopojë),
4. Formimi i Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e komunës së Istogut,
5. Plotësim Ndryshimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit- pyes ekzekutivin dhe anëtarët e Kuvendit a kanë diçka rreth rendit të ditës? Unë e kam një pikë shtesë për rendin e ditës së sotme, Plotësim Ndryshimi i Vendimit për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, janë disa anëtarë që duhet të zëvendësohen. Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- unë nuk kam diçka, vetëm desha një pyetje që e kam bërë mbledhjen e fundit, përgjigjia e asaj pyetje nuk më është kthyer? Pasi që është kryetari këtu, besoj keni mbajtur shënime. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Negjdet! Po e hedh në votim propozimin tim, Plotësim Ndryshimi i Vendimit për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 24 vota pro 0 kundër dhe 0 abstënim votohet që kjo pikë të hyjë në rendin e ditës së sotme.

Kryesuesi i Kuvendit- e hëdh ne votim rendin e ditës me propozimin e dhënë, Kush është që të procedojmë me këtë rend dite për mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 24 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje mungojnë Liridona Lajçi Avdiaj, Fjolla Ukaj dhe Njomza Demaj për shkaqe shëndetësore.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime? Pasi që nuk ka diçka tjetër e hedh në votim kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 23 vota pro 0 kundër dhe 1 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- përshëndet të gjithë të pranishmit! Është një proces që ka filluar tash e më shumë se dy vite. Kërkesa ka ardhur prej Zyrës së Kryeministrit në atë kohë me ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe normalisht pas prezantimit të idesë për instalimin e baterive në zonën e Istogut dhe për krijimin e një mundësie për investim koxha të madh në të njëjtën kohë stabilitet me furnizim me energji elektrike me prioritet komunën e Istogut, duke marrë parasysh gjendjen e lirë të parcelës që e kemi pasur dhe interesin e madh si komunë e mbi të gjitha garantimin me furnizim të energjisë elektrike. Ne e kemi miratuar në parim propozimin ose kërkesën e Zyrës së Kryeministrit e pastaj kemi vazhduar me zhvillimin e procedurave ligjore që e ka aprovuar dhënien e kësaj parcele në sipërfaqe prej 5 hektarësh. Kërkesa e tyre ka qenë 3 deri në 5 hektarë, por marrë parasysh mundësinë e zgjerimit, ne kemi vendosur që me e bërë propozim vendimin normalisht pas miratimit të Kuvendit që 5 hektarë të kalojnë në shfrytëzim të Korporatës së re që është krijuar për Ruajtjen e Energjisë. Normalisht që këto investime i kanë pasojat e veta në ambient, por do merremi me këtë çështje, jetëgjatësia e baterive është nga 25 deri në 30 vite nëse nuk gaboje pastaj do të shohim se si do të eliminohen që mos të mbeten si gjërmadha në pronat komunale. Kisha kërkuar nga secili prej jush që në mënyrë direkte me e përkrah sepse është në interes të komunës, qytetarëve, bizneseve, dhe besoj është një prej mundësive që lehtësojnë krizat ku shpenzimi me energji të elektrike është shumë i madh. Faleminderit kryesues!

Kryesuesi i Kuvendit- e hapim debatin, a e dëshiron dikush fjalën? Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- kjo nuk është vetëm interes i komunës tone, por është interes nacional, prandaj ku me marrë që ka investime të tilla në komunën tonë, me këto bateri sigurohet rryma, prandaj grupi jonë jemi pro kësaj kërkesë dhe nuk kemi se çfarë të shtojmë përtej fjalëve të kryetarit.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- edhe ne si grup e përkrahim këtë investim që është investim mjaft i qëlluar i qeverisë, kështu që jemi pro. Faleminderit shumë!

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka? Pasi që jo e hedh në votim.

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 24 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim-Vendimit për Ndarjen e Pronës Komunale për Ndërmarrjen Publike Qendrore Korporata e Ruajtjes së Energjisë KRE SH.A (Lokacioni Bellopojë).

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- unë si Kryesues në këtë pikë nuk duhet të jem i pranishëm do dale jashtë dhe e kisha ftuar këshilltarën më të vjetër znj. Ajshe Metaj ta kryesoj mbledhjen për këtë pikë të rendit të ditës.

Ajshe Metaj (Kryesuese e kësaj pike)- përshëndet të gjithë të pranishmit! Siç e theksoj kryesuesi unë këtu jam kryesuese për këtë pikë të rendit të ditës, pasi që sipas neneve që u ceken, prania e tij këtu do të ishte konflikt interesi. Dhe menjëherë ja kaloj fjalën kryetarit të komunës për këtë pikë.

Kryetari i Komunës- fjalën e ka drejtori Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- ne si drejtori komunale e Arsimit, kërkojmë nga anëtarët e Kuvendit që të marrim aprovimin e dy kandidatëve që janë për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore, nën 1 është z. Naim Sadriu-zyrtar për monitorim vlerësim dhe standarde nga zyra e DKA-së dhe nën 2 znj. Fatmire Rugova, drejtoreshë e kopshtit "Gëzimi Ynë" në Istog. Një sqarim do ja u jap, tani me ligjin e ri për përzgjedhjen e drejtorëve, çdo konkurs që hapet duhet të jetë komisioni i ri. Të njëjtit por që duhet të merr aprovim nga Kuvendi. Nuk është me mandat, por në të njëjtin konkurs i kemi përfshirë katër konkurse që deri në muajin gusht me nuk kemi nevojë të marrim aprovimin. Faleminderit!

Ajshe Metaj (Kryesuese e kësaj pike)- e hapim diskutimin fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- me prezantimin e këtij komisioni grupi ynë është kundër për shkak se edhe në raporte të integritetit edhe të transparencës ka dalë që ka politizim në arsim në Istog, kështu që nuk ishte e rrugës që një familjar i një partie politike në këtë rast të kryesuesit të ishte në komision përgjegjës për drejtorë të shkollave. Besoj që komuna e Istogut ka pasur mjaftueshëm drejtorë të tjerë e jo familjarë të kryesuesit. Kështu që si grup jemi kundër, nëse mundet drejtori me ardhë me një propozim tjetër ne jemi pro me i hap rrugë këtij komisioni por jo me mëdyshje me ju lënë qytetarëve për politizim në arsim.

Ajshe Metaj (Kryesuese e kësaj pike)- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- faleminderit kryesuese e kësaj pike. Agron, çështje të cilat i kuptoj në momente të diskutimeve politike mirëpo drejtoresha është drejtoreshë e çerdhes para se me qenë Enveri kryesues e unë kryetar. Është mandat që e ka fituar prapë edhe përmes inspektorëve të arsimit që janë regjional. Herën e kaluar ka qenë Mimoza në atë komision tani është Fatmirja, unë nuk shoh politizim.

Ajshe Metaj (Kryesuese e kësaj pike) – fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- unë për profesionalizëm nuk thashë asgjë. Vetëm thashë që në këtë komision keni mundur që të vendosni drejtorë sa të doni dhe ka profesionistë mjaftueshëm. Përndryshe nuk e kontestoj profesionalizmin e askujt.

Ajshe Metaj (Kryesuese e kësaj pike)- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- për afërsisht edhe unë i kam shqetësimet e njejta, drejtori ka thënë që e kam plan me e depolitizuar arsimin, po shihet, sa herë kemi komisione të tilla duhet dikush të dalë jashtë, d.m.th po duhet vetëm familjarët e një rrethi të ngushtë të kryesisë së LDK-së me u zgjedh në këto komisione, a nuk ka Istogu ekspertë të tjerë. Edhe Lëvizja Vetëvendosje është kundër.

Ajshe Metaj (Kryesuese e kësaj pike)- fjalën e ka drejtori Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- kam thënë që nuk ka politizim në arsim dhe nuk ka. Arsyeja pse është drejtoresha Fatmire është sepse të gjithë drejtorët janë në konkurs, ndërsa përfaqësuesi i ministrisë nuk është ai i yti as i imi, por i ministrisë që do të marrë pjesë në komision. Drejtoresha është drejtoresha më e vjetër në detyrën e saj nuk ka politizim në institucionet, po të garantoj që edhe ligji e thotë që duhet të jetë drejtoresha më e sukseshme gjithashtu edhe kuota gjinore e kërkon ta kemi një prej gjinisë femërore. Për këtë arsye jemi detyruar ta marrim drejtoreshën Fatmire, e jo që është gruaja e kryesuesit.

Ajshe Metaj (Kryesuese e kësaj pike)- a e dëshiron edhe dikush fjalën? Pasi që jo e hedh në votim, kush është të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatohet që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 13 vota pro 9 kundër dhe 1 abstenim miratohet pika e rendit të ditës 'Formimi i Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e komunës së Istogut.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- besoj prej materialit që e keni marrë për këtë Rregullore, për dallim prej herës së fundit materiali ka qenë i bashkëngjitur me propozimet që kanë ardhur edhe nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Ndryshimet janë të nëni 8 të drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, të pika 1. Shfrytëzimi i hapësirës në Shtëpinë e Kulturës "Adem Jashari" pika 1.1 Salla e madhe e koncerteve për një mbremje, çmimi nga 200.00 euro dhe propozimi dhe kërkesa ka ardhur të zbritet në 100.00 euro. Arsyeja është që salla të jetë e shfrytëzueshme. Të pika 1.6, Dhënia në shfrytëzim e hapësirave rreth shtëpisë së kulturës m² mujore; çmimi nga 3.00 euro, zbritet në 1.00 euro, si dhe e fundit pika 1.7, dhënia në shfrytëzim e zyrave në Shtëpinë e Kulturës m² mujore; çmimi nga 1.50 euro, zbritet në 0.70 cent. Këto janë tri ndryshimet të nëni 8, arsyeja pse ka ardhur ky plotësim-ndryshim në këtë kohë është sepse për momentin janë edhe kërkesat për shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin për këtë pikë? Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- pasi po bëhet fjalë për Shtëpinë e Kulturës desha ta marrë përgjigjen nga kryetari, desha ta di për atë sallë që është që dy vite që komuna nuk ka qasje, pse nuk ka mundësi dikush të konkuroj ta marrë atë sallë të mbajë mbremje rinore, ajo mbahet nga një person që është i afërt me kryetarin për këtë arsye me interesoj përgjigjia prej kryetarit. Këtë mundemi ta lëmë pikën pikën e fundit. Desha të ndërlihem të pagesat është e cekur aty mirë veteranët dhe familjarët e tyre, por ne e kemi votuar në të njëjtën kohë edhe për lirin e stafit policorë të stacionit në Istog ne e kemi cekur aty për lirin nga shërbimet në spitalin e Istogut për pagesën prej 2.00 euro, MAPL-ja mundet me e kthyer si të jashtëligjshme për shkak se e kemi futur edhe policinë e Istogut njëjtë sikur veteranët e familjet e dëshmorëve, lirohen nga të gjitha pagesat administrative edhe policia e Istogut. Nëse doni t'i lironi edhe ata atëherë duhet me i votuar prej fillimit. Sepse është e cekur saktë aty.

Kryesuesi i Kuvendit- kjo është votuar vitin e kaluar Negjdet me një propozim nga Andi Xhuraj, edhe ministria e ka kthyer në rregull. Kjo është kompetencë komunale, edhe policia e kanë atë të drejtë. Sa i përket pyetjes drejtoresha e drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, ka kërkuar falje për sot që nuk është e pranishme në mbledhje për shkak se është me grip. Fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- sa i përket pyetjes së Negjdetit të pjesa e Policisë, bashkë me zyrtarë të ministrisë që na kanë ndihmuar të pjesa e formulimit sepse ka qenë një veprim i panjohur edhe për ta, se asnjë komunë tjetër në Republikën e Kosovës nuk e ka një

lirim të tillë për pjesëtarët e Policisë, e kanë harmonizuar dhe e kanë bërë pjesë të një neni. I gëzojnë këto të drejta vetëm pjesëtarët e Policisë jo familjarët e tyre, për dallim prej veteranëve dhe invalidëve. Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a e dëshiron edhe dikush fjalën? Negjdet Ramaj e ka kërkuar fjalën.

Negjdet Ramaj- besoj që pyetjen time e ka marrë me shkrim. Desha ta di për atë sallë se çfarë po ndodhë. Desha ta marrë përgjigjen nga ti kryetar sepse është i afërm i yti. Pse me e pas a çelsin e jo drejtori Maxharraj.

Kryetari i Komunës- ligjërisht salla është në shfrytëzim të Dardan Bytyqit me vendim të ish kryetarit Rugova. Vendim që përderisa nuk na shfaqet ndonjë nevojë tjetër apo kërkesë, interes i madh publik nuk kemi nevojë me e ndërruar. Kjo është përgjigjia ime për ty.

Kryesuesi i Kuvendit- replikë Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- unë kam pasur kontakt me njerëz që janë të interesuar me marrë atë sallë edhe me e paguar, ai e ka vendimin siç e ceke por ai nuk paguan asgjë.

Kryetari i Komunës- nëse ke pasur kontakt me këta njerëz tregoj që sallën e lëshon në shfrytëzim kryetari me drejtorët e jo kuvendarët. Zyren hap e kam, kur të duash hajde e diskutojmë.

Negjdet Ramaj- janë të interesuar ta marrin, dhe ne e kemi votuar këtu që hapësirat publike kur lëshohen duhet me e paguar 1.50 euro për m². nuk është e logjikshme që ti japet dikujt si ojq jo fitimprurëse e aty janë mbajtur mbrëmje rinore që ka qenë hyrja ndoshta 10.00 euro. Që dy vite ajo nuk është hapur e nuk ka pasur as mbrëmje rinore. Pse me ju lënë çelësi atij djali e mos me pas qasje askush aty, se është hapësirë publike.

Kryetari i Komunës- po ta them prapë ajo sallë është e dhënë në shfrytëzim, ka edhe të tjera lokale që janë të dhëna në shfrytëzim pa pagesë që janë të dhëna për interes publik. E thashë, kur del një interes i madh publik që hyn në funksion ajo sallë ne sigurisht që kemi me i shqyrtuar kërkesat, por kërkesat nuk bëhen në kafe ose në rrugë por bëhen në kat të parë këtu, ku i drejtohet kryetarit eventualisht drejtorit përkatës.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- u përmend që ka pasur mbrëmje rinore, unë e di që prej vëre nuk ka pasur. A mundet dikush me na sqaruar çfarë aktivitete ka pasur prej atëherë pasi qenka duke u mbajtur në shfrytëzim. Kishte me qenë mirë që nëse dikush e merrë një sallë dhe nuk e shfrytëzon për asgjë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genç Ademaj.

Genç Ademaj- ta kemi parasysh një gjë. Aktivitetet deri në fund të vitit 2021 kanë qenë të ndaluara për shkak të Covidit. Pastaj shtëpia e Kulturës ka qenë komplet në renovim me fonde për energji dhe efikasitet. Me i mbledhë tri vite zyret kanë qenë komplet jashtë funksionit dhe kjo ka qenë një ndër arsyet që nuk ka pasur aktivitete as në sallën e madhe, amfiteatrin që e ka qyteti. E dini që vitin e kaluar edhe me drejtoreshën që ka qenë Eliana e pastaj Vloren, e kemi bërë një komision për identifikimin e hapësirave publike nga kush shfrytëzohen e pastaj me shkuar me marrëdhënie kontraktuale që thjeshtë me qenë në dijeni se kush po i shfrytëzon ato zyre. Vitin e kaluar i kemi lidhur kontratat edhe këtë vit me të drejtë nga ana e tyre, që kanë qenë pak tarifat e larta, e pastaj e kemi bërë kërkesë te Komiteti për Politikë dhe Financa që me i bërë këto lirime të qirasë vetëm me arsyen që me qenë më të përballueshme për ata shfrytëzues. Tani jemi në fazën e kontraktimit të shfrytëzuesve pas lirit që bëhet d.m.th më e favorshme për organizatat, mundemi me e sjellë edhe një raport të detajuar për të gjitha hapësirat Brenda shtëpisë së Kulturës, sa shfrytëzohen edhe sa e kanë tarifen e pagesës të asaj qiraje. Me rendësi është që me e pasur edhe ju si anëtarë të Kuvendit një informacion të saktë se kush janë shfrytëzuesit edhe sa paguajnë taksë. Është fjala për kontratat e reja se ato të vjetrat janë të publikuara në web faqe të komunës që e kemi diskutuar edhe më herët. Nuk ka pengesë për shfrytëzimin e hapësirave në shtëpi të Kulturës sepse realisht nuk ka as kërkesa.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- kanë mbajtur mbledhje rinore në vitin 2022, kur e thashë unë e uzurpuar, nuk e thashë në atë kuptimin që e ka uzurpuar, por në momentin që nuk ka qasje drejtori Maxharraj se ai me letra është në rregull, por ne po mundohemi të funksionojmë me ligj jo në baza shoqërore.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- apo thua që është mirë me letra? Ku është problemi pra. Nëse ka problem ligjor mund të na tregosh merremi edhe ne me të.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- ai me letra e ka marrë atë. Por me e marrë një hapësirë publike dhe me thënë që është organizatë joqeveritare, me mbajtur mbledhje rinore me përfituar dikush fort aty e komuna mos me e marrë asnjë cent, unë nuk e di se çfarë rregulli është.

Kryetari i Komunës- tani nëse ne i tarifojmë organizatat rinore, cila është përkrahja që po ja bëjmë rinisë? Duhet me e ndarë mendjen a duam t'i përkrahim apo t'i tarifojmë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- në qoftë se një kohë të gjatë dikush nuk e shfrytëzon një sallë, me e thirr atë edhe me i thënë nëse nuk po të duhet, ta qesim mos po e merr dikush tjetër. Edhe i pata vërejtjet, tash po thuani organizatë jofitimprurëse, ato letra pra janë të rreme sepse aty është shitur alkool e nuk është organizatë jofitimprurëse se njerëzit kanë paguar hyrje. Edhe nuk kam qenë në dijeni që drejtori aty nuk ka qasje në sallë.

Genc Ademaj- më fal që po të ndërprejë në fjalim. Nuk ka institucion publik që një person përgjegjës i atij institucioni nuk ka qasje.

Kryetari i Komunës- është e rrugës që para se me i diskutuar me i analizuar ligjërisht qoftë nga ana politike qoftë personale edhe me i parë të drejtat e atij që japet në shfrytëzim me e parë a ka mangësi në atë dhënie në shfrytëzim e pastaj me i godit politikisht ato mangësi të cilat 'supozojeni' që janë në bazë të analizës që ju e keni bërë, përndryshe kur nuk ka mangësi, kur ligjërisht gjërat janë në rregull, dhe kur nuk është i paraqitur një interes publik gjërat vazhdojnë të rrjedhin ashtu siç janë. Në momentin që e shihni që ka interes më të madh publik, këtu jemi, orientoni njerëzit, kur paraqitet një interes me i madh krejt ky ekzekutiv ka me shku andej, por nëse doni me e mbajtur në nivel politik urdhëroni diskutoni.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetari ishte mjaft transparent, nëse dikush ka interes le të urdhëron. Atëherë pasi që diskutimi përfundoi, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës pra Rregulloren kështu siç është e propozuar?

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 5 abstenime votohet pika e rendit të ditës 'Plotësim-Ndryshimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- Plotësim Ndryshimi i Vendimit Nr.35/2022 për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Këtu i kemi tri ndryshime tek anëtarët e këtij këshilli, Tahir Bekaj zëvendësohet me Shemsedin Zymberaj pasi është zgjedhur kryetar i bashkësisë Islame në Istog, Seah Hotovic nga komuniteti boshnjak zëvendësohet me Adnan Ramic dhe në fund Enisa Corovic nga zyra komunale për komunitete dhe kthim pasi që nuk punon më këtu, zëvendësohet me Almina Eco. E hapi diskutimin. Pasi që nuk ka dikush diçka, e hedh në votim?

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 5 abstenime votohet pika e rendit të ditës 'Plotësim Ndryshimi i Vendimit Nr.35/2022 për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- kisha dashur një sqarim prej drejtorit të Arsimit ditën para zgjedhjeve t'ka mbyllur shkollat në orën 16:00 me arsyetimin për dezinfektim por shkollat nuk janë dezinfektuar. Më herët tha drejtori që janë të depolitizuara shkollat, atë ditë ka qenë fushata e LDK-së dhe profesorët e arsimtarët kanë qenë të ftuar në hotel "Trofta" janë parë edhe nga fotografitë që orët janë lëshuar, gjithashtu edhe nxënësit janë lëshuar. E kisha dashur një sqarim për këtë?

Naim Behlulaj- në radhë të parë unë i kam ruajtur nxënësit që mos të politizohen. Mund të shkoni në KQZ dhe të kërkoni sqarim se a ka kërkuar KQZ-ja që shkollat të jenë të dezinfektuara, pse nuk janë dezinfektuar ato që po thua ti dhe nuk janë të gjitha shkollat janë vetëm katër shkolla që janë lëshuar. Unë nuk e besoj që ju kam thënë mësimdhënësve sepse në shkolla nuk ka vetëm LDK por ka edhe të partive tjera, nuk është e vërtetë që mësimdhënësit kanë qenë në hotel "Trofta" me urdhër timin.

Florin Dreshaj- ishte dashur të dezinfektohet të premten ose të shtunen e jo saktë në atë ditë. Profesoreshat kanë qenë në atë takim se e keni postuar vet. Nxënësit kanë prit më shumë se dy orë autobusët.

Naim Behlulaj- për herë të parë prej që jemi në qeverisje nxënësit nuk kanë marrë pjesë në fushatë zgjedhore. Po foli për ne si LDK. Nëse zëvendësdrejtori yt e ka mohuar është diçka tjetër, unë e kam thirrur prapë të nesërmen vazhdoni me dezinfektim për shkak të gripit.

Florin Dreshaj- nëse ka pasur nevojë të shkojnë në një shkollë nuk ka pasur nevojë të zbrazet një tjetër shkollë, edhe nuk keni pasur as material dezinfektues.

Kryetari i Komunës- prof, pak janë gjëra këndvështrimi, ti mundesh me e vlerësuar edhe mundesh me e pasur mirë prej prespektives tënde, kjo është vetëm sipas teje, po ta respektojmë. Por diskrecionin e vendimeve e merr ai që e ka të drejtën ligjore me marrë vendimin.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- gjatë fushatës janë vërejtur shumë një javë para se me përfunduar fushata, zhavor është shpërndarë shumë në disa pjesë të fshatrave të Istogut. Ato janë rrugë me kërkesa të aprovuara që duhet të asfaltohen dhe janë të aprovuara, nuk janë të asfaltuara ato rrugë dhe po i leni qëllimisht. Ka pasur ankesa në Kovragë lagjia Gjocaj, që janë ankuar vetëm sepse nuk janë votues, pastaj në Uçë te Hasanajt, në Cerkozë nuk ka filluar ende kanalizimi edhe pse është aprovuar, kemi në Zallq lagjia Shalaj edhe aty është dashur të jashtroni asfaltin për vota. Një qendër rinore në Uçë është ndërtuar që katër vite, do kishte qenë mirë me ja vënë rrymën tani e mos me prit në zgjedhje se nuk ka kuptim, edhe ambulanta në Uçë drejtor në vitin 2021 ka përfunduar komplet, vetëm është duke u shkatërruar, kishte me qenë mirë me e hapur atë ambulantë. Faleminderit!

Kryetari i Komunës- pjesa e zhavorit, Abedini ë din më mirë nuk është ashtu. Pak kanë mbetur pa u shtruar, nuk kanë mbetur shumë, mi asflat zall nuk hidhet. Pjesa e familjeve që i etiketove, një pjesë e tyre janë aktivitete që janë përfunduar, kanalizim rrugë e varësisht prej lagjeve edhe prej planifikimeve të buxhetit, buxhet të cilin ju e votoni këtu. Kur vjen koha e zgjedhjeve nuk kanë faj qytetarët Negjdet, edhe ti e din shumë mirë që nuk ua shtrojmë rrugët vetëm njerëzve tonë. Mund të ketë përparësi aty këtu por nuk ka pasur.

Abedin Kabashi- prej zyrës së Shërbimeve Publike realisht asnjë kamion zallë nuk është shpërndarë gjatë fushatës, sepse kam pasur kërkesa me dhjetra por zyra e Shërbimeve Publike nuk i ka shpërndarë, mund të ndodhë prej zyrës së Minoriteteve se edhe ata e kanë planifikimin e tyre për zhavor për me e shpërndarë por realisht nëse i krahason fushatat tjera Abedin Kabashi si drejtor i drejtorisë së Shërbimeve Publike nuk ka shpërndarë zhavor gjatë kësaj fushate. I përmende ato lagje, realisht ata nuk kanë qenë te unë, as ata që i përmende të Uçës në zyre për me kërkuar, e njerëzit që nuk vijnë te unë me e bërë një kërkesë unë realisht nuk i njoh. E përmende edhe shtëpinë e Kulturës në Uçë unë e kam kryer obligimin si drejtori e Shërbimeve Publike e kam bërë kërkesën para vitit të ri për njësoje, kam shkuar vet në zyre të KEDS-it që me pas mundësi me u realizuar ajo.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Zenel Shatri.

Zenel Shatri- së pari Negjdet nuk kemi licencë, sepse ajo është ndërtuar për herë të pare e në Cerkolez ka qenë licenca e hershme, është kërkesa për licencë, por në ministri i kanë disa kritere, e nuk kemi marrë ende përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Naim Behlulaj

Naim Behlulaj- vitin e kaluar i kemi pasur 5.000 euro të ndara për qendrën rinore në Uçë për rrethojë edhe nuk ka mjaftuar. Tri here e kemi hap tenderin nuk ka konkuruar askush se oferta e vogël, d.m.th pare pak e oferta e madhe. Ora zyrtarisht është vendosur, kanë ardhur e kanë lënë orën aty por për shkak që duhet të vendoset lartë dhe ka mbetur të vjen ekipa për atë punë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Arta Balaj.

Arta Balaj- unë e pata një kërkesë prej banorëve që e vizitojnë burimin për drejtorin e Emergjencave, drejtor a kemi mundësi buxhetore me vendosur kamera sepse e dimë që burimin e kemi atraksion dhe është duke u shkatërruar, janë thyer karriget, është dëmtuar ndriçimi, njerëzit që e vizitojnë burimin për çështje sigurie i duan kamerat nëse ka ndonjë mundësi. Edhe një pyetje e kam për drejtorin e Shërbimeve Publike, a keni mundësi me i vendosur disa luhaja në park, këtë kërkesë e kam bërë edhe përpara e kam parasysh që është hequr ajo pjesa e shtëpizës që është keqpërdor prej adoleshentëve dhe është bërë shumë mirë. Parku është duke u frekuentuar shumë.

Abedin Kabashi- po në mbledhjen para vitit të ri e ke theksuar që duhet të hiqet ajo kabina aty dhe e ke shtuar nevojën e luhajave. Brenda pak ditëve kam marrë masa edhe është hequr ajo kabina aty. Jam marrë vesh me kompaninë që merret me mirëmbajtjen e parkut gjatë muajit Maj me i vendosur edhe disa luhaja edhe disa ulëse tjera shtesë. Dua të ju përgjigjem edhe Negjdetit te pyetja për kanalizimin në Cerkolet është u buxhetuar, nëse shpëton pa e marrë përmbaruesi, se na janë marrë shumë mjete, mbi 10 projekte janë të larguara.

Xhevat Demaj- ne vitin e kaluar në të gjitha pjesët e qendrës kryesore të komunës kemi vendosur kamera, por për shkak të buxhetit nuk kemi pasur mundësi ende, e marrë parasysht dhe këtë vit besoj që do i vëmë edhe atje.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- për drejtorin e Shërbimeve Publike e kam një pyetje a ka filluar kanalizimi në fshatin Lluga apo jo? Për drejtorin e Arsimit i kam dy pyetje, e para është pyetje që e kam bërë shumë herë për këtë çerdhen te policia pse ka mbetur se po shihet që vetëm është duke u shkatërruar, dhe pyetja tjetër, salla e sportit te gjimnazi te cila fazë është?

Abedin Kabashi- profesoreshtë kanalizimi në Saradran, konkretisht në lagjet e poshtme të llugave, do të filloj në fillim të muajit Mars. Projekti ka qenë dy vjeçar, punimet do të fillojnë shumë shpejt kam qenë në terren me kompaninë dhe kemi përcaktuar fazën e pare që do të jetë afërsisht 3000 m këtë vit, e çka do të mbetet pa u kryer do përfundoj vitin tjetër.

Naim Behlulaj- sa i përket çerddes fatmirësisht takimin që e kemi pasur javën e kaluar me zyrtarët nga ministria që kanë qenë edhe e kanë pare gjendjen e saj, na kanë premtuar që në fillim të Marsit do të hapet tenderi i ri për çerdhen e Istogut edhe pse fatmirësisht kam raporte jashtëzakonisht të mira me ministren dhe më ka premtuar që shumë shpejt do të aktivizohet kjo çerdhe. Ndërsa sa i përket palestrës ditën e djeshme kanë qenë zyrtarët e ministrisë së arsimit një prej tyre edhe menaxheri që e kqyr drejtpërdrejtë palestrën dhe na kanë premtuar që shumë shpejt do të përfundoj ky projekt.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Valbone Demaj.

Valbone Demaj- desha të ndërlidhem pak me kolegun tim Negjdetin që e përmendi që gjatë fushatës janë bërë asfaltime te ata njerëz që kanë qenë vetëm pjesë e LDK-së, unë dua ta dëshmoj që unë jam e LDK-së edhe i kemi dy rrugë që janë nga 450 metra që kanë hyrë në buxhet dhe nuk janë shtruar ende, dhe pikërisht dua ta përmend rrugën që është fermeri që e ka zënë vendin e pare në Kosovë, z. Sadik Demaj që e ka një rrugë 450 metra që nuk ju ka shtruar. Desha ta them shkurt dhe të kërkoj te drejtori Abedin Kabashi që t'i ketë parasysht sidomos këtë rrugë. E kam pasur edhe një pyetje për drejtorin e Bujqësisë por nuk qenka këtu është ndërtimi i kanalit të ujitjes edhe aty janë

tre fermerë që e ujitin tokën prej atij kanali. Nëse ka buxhet kishë pasur dëshirë me ma kthyer përgjigjen ose mbledhjen tjetër ose me shkrim.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Nexhmedin Balaj.

Nexhmedin Balaj- edhe unë e kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike për dëmtimin e rrugëve që janë bërë kanalizimi ujësjellësi, bukur një kohë është ashtu drejtor, çka mundet diçka më shpejt të bëhet, ndoshta po e din për cilat pjesë po flas.

Abedin Kabashi- po ti e ke pyetjen për rrugën e juaj në Lluga, realisht gypi që është i ujësjellësit nuk po i përmban presionit që e ka uji. Para tri dite që ka qenë defekti në Muzhevinë në hyrje të rrugës kam qenë vet prezent dhe gypi është shumë i vjetër dhe nuk po e përmban presionin e ujit. Ose duhet me e bërë një investim nga kompania "Hidrodrini" edhe komuna sigurisht për me e ndërruar gypin krejt për me qenë me standarde më të reja. Por ato dëmtimet ose prerjet që po bëhen, ne e kemi kontratën për sanimin e prerjeve të asfaltit, e kam kontaktuar kompaninë "Graniti" dhe më ka premtuar që deri në muajin Mars nuk mund të filloj për shkak se koha nuk është e përshtatshme për asfalt.

Kryesuesi i Kuvendit- e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:29

Procesmbajtëse,
Flora Bujupaj

Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova